Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligj "*Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar"*[1].

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Projektligji është publikuar nga Ministria e Financave në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike datë 26.04.2024.

https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/729

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin *"Për një ndryshim në ligjin nr.61/2012 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar*", janë si më poshtë vijon:

Takime me grupet e interesit: Gjatë muajit prill 2024, janë zhvilluar takime në nivel teknik nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shoqëritë prodhuese të birrës vendase dhe importuesit me qëllim prezantimin e projekit të ri, problematikave, si dhe mundësitë e zgjidhjes.

Mbledhje e mendimeve dhe sugjerimeve nëpërmjet postës elektronike, si dhe shkresave:

Projektligji i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministrit e Shtetit dhe Kryenegociator dhe ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

-Ministria e Drejtësisë, ka shprehur disa komente/sugjerime të cilat janë reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit, duke dhënë dhe argumentat përkatëse në relacionin shoqërues.
-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit janë shprehur dakord, me disa sugjerime për të cilat janë dhënë argumentat përkatëse në relacionin shoqërues.

[1] Projektligji ka si qëllim:
- përcaktimin që nga data 01 janar 2025, pulla fiskale si letër me vlerë dhe monopol shtetëror, do të prodhohet dhe shpërndahet nga një person i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.
- elementët e sigurisë dhe çmimi i pullës fiskale, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në linkun: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/729

4. Palët e interesit të përfshira

Gjatë muajit prill 2024, janë zhvilluar takime në nivel teknik nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shoqëritë prodhuese të birrës vendase dhe importuesit.

Projektligji "*Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar",* është hartuar nga Ministria e Financave.

Konsultimi është kryer me grupet e interesit, por dhe aktorë të tjerë në nivel qendror si ministritë e linjës dhe instritucione të tjera si Ministria e Drejtësisë, Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe insitucionet e varësisë së MFE si DPD.

Procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente edhe pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

5 . Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (*psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)*	Komenti *(grumbulloni dhe përmblidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)*	Palët e interesuara *(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)*	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi